

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6797
E premte, 6 janar 2023
çmimi 0.40 €

A rrezikon Evropa
ta humbasë rëndësinë e
saj në këtë shekull? | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

VUÇIQI PARALAJMËRON NËNTË ÇNJOHJE, SHOQËRIA CIVILE DHE OPOZITA TË SHQETËSUARA ME HESHTJEN E GËRVALLËS | FAQE 4-5



Shoqëria civile dhe opozita janë shprehur të shqetësuara me heshtjen e ministres së Punëve të Jashtme, Donika Gërvalla, pas paralajmërimit të presidentit të Serbisë Aleksandër Vuçiq, se nëntë

shtete e kanë tërhequr njohjen e Kosovës. "Ajo që më shqetëson është heshtja e Ministrisë së Punëve të Jashtme", ka thënë ish-ambasadorja e Kosovës në Uashington, Vlora Çitaku. E profesori universitar Fadil

Maloku ka theksuar se si qytetar i thjeshtë dëshiron të dijë nga ministrja Gërvalla se çfarë është duke ndërmarrë Ministria e Punëve të Jashtme në lidhje me këtë paralajmërim për çnjohje

AKTUALE



BE-ja REKOMANDON QË PASAGJERËT
NGA KINA TË PARAQESIN
TEST NEGATIV PËR COVID-19 | F.2

OPOZITA PYET KURTIN:
ÇFARË PO NDOHDH? ALEATJA
JONË KRYESORE, SHBA-ja,
THOTË SE NUK ËSHTË KOHA PËR
NJOHJE ME SERBINË | F.3

VARROSET PAPA BENEDIKTI XVI | F.7

EKONOMI



VAZHDON RITJA E ÇMIMEVE TË
PRODHIMEVE BAZË EDHE KËTË VIT | F.8

TAHIRI: REZULTATI I KËSAJ
QEVERIE, IKJE E TË RINJVE DHE
MUNGESË INVESTIMESH | F.8

SPORT



FBK-ja KA PRIORITET
ZHVILLIMIN DHE MASIVIZIMIN
E BASKETBOLLIT 3X3 | F.12



MOISIU:
KALOVA SHTATË
PORTA PËR TË
SHKUAR TE
THAÇI, MË ERDHI
RËNDË KUR
E PASHË ATJE | FAQE 3



HAMZA TAKON TË DËRGUARIN E
POSAÇËM TË BRITANISË, TEMË DISKUTIMI
SIGURIA NË MITROVICË | FAQE 6

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
+377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Dhoma e Përfaqësuesve sërish dështon ta zgjedhë kryetarin e ri

WASHINGTON, 5 JANAR - Republikanët në Dhomën e Përfaqësuesve as në ditën e dytë nuk kanë arritur ta zgjedhin Kevin McCarthy në pozitën e kryetarit. Në votimet që u mbajtën të mërkurën McCarthy nuk hoqi dorë nga gara, por dështoi të zgjedhej në raundin e katërt, të pestë dhe të gjashtë. Republikanët dhe demokratët nuk arritën as të pajtoheshin që ta shtynin votimin për një natë tjetër, duke shkaktuar konfuzion. Po ashtu, as të martën republikanët nuk arritën që në tre raundet e para të zgjedhnin kryetarin e ri, edhe pse ata kanë shumicën në Dhomën e Përfaqësuesve. “Ende nuk ka marrëveshje”, tha McCarthy teksa u largua nga një takim me republikanët. “Por, ka shumë përparim”, shtoi ai. Megjithatë, gjatë votimeve nuk u panë shenja të përparimit. Gjatë raundeve të votimit rezultati ishte pothuajse i njëjtë, me 20 ligjvënës konservatorë që refuzuan ta mbështesin

McCarthy. Atij i duhen 2018 vota për t’u zgjedhur në krye të Dhomës së Përfaqësuesve. Gjatë votimeve të mërkurën mbrëma, mbështetja për McCarthy ra në 201 vota, pasi disa republikanë zgjodhën që të mos votonin për të. Duke parë se nuk kanë marrëveshje, republikanët votuan që ta shtynin sërish për disa orë votimin teksa po tentojnë të arrijnë ujdi për t’i dhënë fund kaosit të shkaktuar në Dhomën e Përfaqësuesve. Ata dëshironin që të ktheheshin sërish për të votuar, por McCarthy kërkoi pushim deri të enjten. “Mendoj se njerëzit duhet të punojnë edhe më pak. Nuk mendoj se votimet sonte do të bëjnë ndonjë dallim, por votimet në të ardhmen mund”, tha ai. McCarthy, republikan nga Kalifornia, luftoi ta siguronte mbështetjen përmes takimeve të mbyllura me ligjvënës republikanë. Zgjedhja e kryetarit të ri të



Dhomës së Përfaqësuesve është kyçe pasi pa u zgjedhur ai nuk mund të betohen anëtarët e rinj të Dhomës, të formohen komitete, të çohen përpara ligje e as të hetohet administrata e presidentit amerikan Joe Biden. Për zgjedhjen e kryetarit të ri duhen 218 vota nga 435 ligjvënës sa ka Dhoma. McCarthy u bë kandidati i parë në 100 vjet që nuk arriti të

zgjedhet kryetar i Dhomës në votimin e parë pavarësisht se partia e tij ka shumicën. Gjatë zgjedhjeve të mesmandatit, republikanët fituan një shumicë të ngushtë në Dhomë, 222-212. Presidenti amerikan Joe Biden, teksa po nisej për një ngjarje në Kentuki, tha se “e gjithë bota po shikon” se çfarë po ndodh në Dhomën e Përfaqësuesve.

“Mendoj se është e turpshme që po zgjat kaq shumë”, tha Biden. “Nuk e kam idenë” se kush do të fitojë, shtoi presidenti amerikan. Hera e fundit që Dhoma e Përfaqësuesve nuk zgjodhi kryetarin në votimin e parë ishte viti 1923 kur votimet zgjatën në nëntë raunde votimi. Edhe atëbotë republikanët kishin shumicën në Dhomë.

Putini: I gatshëm për bisedime me Ukrainën nëse pranon realitetet e reja territoriale



MOSKË, 5 JANAR - Presidenti rus Vladimir Putin i tha homologut turk Rexhep Tajip Erdogan se është i hapur për dialog me Ukrainën nëse Kievi pranon se territoret e pushtuara nga Moska janë territore ruse, ka njoftuar Kremli më 5 janar. “Putini edhe një herë konfirmoi gatishmërinë për dialog serioz, me kusht që autoritetet e Kievit t’i përmbushin kërkesat e paraqitura tashmë dhe që janë të njohura”, ka njoftuar Kremli

përmes një deklaratë. Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt dhe ka pushtuar disa pjesë në lindje dhe jug të shtetit. Kremli pretendon se ka aneksuar rajonet e Donjeckut, Luhanskut, Zaporizhjes dhe Hersonit pavarësisht se nuk i kontrollojnë plotësisht këto rajone. “Pala ruse theksoi rolin shkatërrues të shteteve perëndimore që po furnizojnë me armë dhe pajisje ushtarake regjimin e Kievit dhe

po i ofrojnë informacione operacionale”, u tha në njoftim. Ndërkaq, sipas njoftimit të Ankarasë, Erdogan i ka kërkuar Putinit të shpallë armëpushim “të njëanshëm” në Ukrainë. “Presidenti Erdogan tha se thirrjet për paqe dhe negociata duhet të mbështeten nga një armëpushim i njëanshëm dhe një vizion për zgjidhje të drejtë”, tha zyra e Erdoganit pas bisedës telefonike midis liderit turk dhe atij rus.

BE-ja rekomandon që pasagjerët nga Kina të paraqesin test negativ për Covid-19

BRUKSEL, 5 JANAR - Zyrtarët e qeverive të Bashkimit Evropian rekomanduan që pasagjerët që udhëtojnë nga Kina për në BE duhet të kenë test negativ për koronavirus para se të nisen për në Evropë. Ky rekomandim vjen në kohën kur Pekini po përgatitet t’i lehtësojë masat e udhëtimit pavarësisht se shteti po përballet me një valë të re të infektiveve me sëmundjen Covid-19. Rekomandimi u bë nga Grupi i Integruar Politik për Përgjigje ndaj Krizave që përbëhet nga

zyrtarët e 27 shteteve të BE-së dhe është në linjë të njëjtë me rekomandimin e bërë paraprakisht nga Komisioni Evropian. Pekini planifikon t’i lehtësojë kufizimet për udhëtime më 8 janar pavarësisht një vale të re të infektiveve që ka ngarkuar spitalet dhe morgjet në Kinë. Grupi i BE-së, po ashtu, rekomandoi që të gjithë pasagjerët në fluturimet për dhe nga Kina duhet të mbajnë maska. Po ashtu, u tha se qeveritë e BE-së mund të aplikojnë teste rastësore të



pacientëve që arrijnë nga Kina dhe, po ashtu, do të marrin mostra dhe t’i testojnë ujërat e

zeza nga avionët që vijnë nga Kina. Testin negativ për udhëtarët

nga Kina e kërkojnë autoritetet në Spanjë, Francë dhe Itali. Kina tashmë ka kundërshtuar këto veprime, duke paralajmëruar për “kundërmasa” nëse një politikë e tillë do të vendosej në mbarë bllokun evropian. Pekini, pas pothuajse tre vjetësh, muajin e kaluar njoftoi për lehtësimin e masave. Rastet me koronavirusin e ri fillimisht ishin regjistruar në fund të vitit 2019 në Kinë. Që atëherë ky virus ka mbytur mbi 6.7 milionë persona në mbarë botën.

Opozita pyet Kurtin: Çfarë po ndodh? Aleati ynë kryesor, ShBA-ja, thotë se nuk është koha për njohje me Serbinë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 JANAR - Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka reaguar në lidhje me deklaratat e fundit të zyrtarëve amerikanë se njohja nuk është pjesë e marrëveshjes në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Lideri i LDK-së ka kujtuar se më 7 shkurt të vitit 2021, presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Joe Biden, nëpërmjet një letre urimi, i kishte kërkuar presidentit të Serbisë, Vuçiq, arritjen e një marrëveshje gjithëpërfshirëse me Kosovën të përqendruar në njohjen e ndërsjellë. "Pra njohja e ndërsjellë, respektivisht njohja e pavarësisë së Kosovës nga Serbia, ishte politikë qendrore e administratës Biden. Si një nga presidentët më të përfshirë me çështjen e Kosovës, që nga vitet e '90 e kënde, Joe Biden dhe qëndrimi këmbëngulës për Kosovën, shpërfaqnin një mundësi

të jashtëzakonshme për popullin e vendin tonë. Saktësisht dy vjet me qeverinë Kurti dhe pozicioni ndërkombëtar i Kosovës duket qartazi i rënduar. Tani aleati ynë kryesor thekson se koha nuk është për njohje", ka thënë ai.

Abdixhiku ka theksuar se ky qëndrim vjen si pasojë e papërgjegjësive populiste që për politikë turmash jo që s'arriti të përfitojë nga kjo administratë, por pariparueshëm degradoi relacionet në qëndrime që tani dhe normalizojnë mosnjohjen. "Dhe kështu, si në asgjë, në momentin më të mirë në dekada për Kosovën, e në momentin më të rëndë për Serbinë e aleatin e saj Rusinë - Qeveria e Kosovës bëri të pabëshmen, regresoi në fundament me partnerë strategjikë duke i dhënë një dhuratë të papritur kundërshtarit tonë historik. Liderët shtetërorë i detyrohen popullit të Kosovës një shpjegim se si arritën në dy vjet të tyre deri te ky përfundim. Sepse



politika e tyre e theqafjes nuk përbën asnjë shpjegim patriotik", ka deklaruar Abdixhiku.

Edhe nënkryetarja e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Vlora Çitaku, ka theksuar se një marrëveshje gjithëpërfshirëse pa njohjen reciproke nuk është as finale e as gjithëpërfshirëse. "Kryeministri duhet të na e sqarojë se si qenka katandisur procesi deri në atë pikë sa aleatët tanë po thonë tani që nuk është koha për njohje reciproke? Duhesh me qenë tej mase amator e i padijshëm që në kontekstin gjeopolitik më të favorshëm për Kosovën në 15 vjetët e fundit, në vend të marrëveshjes për njohje, të kemi

një status quo të re, pa njohje dhe me asociacion. Ja gjenialiteti i kryeministrit", ka shkruar Çitaku në "Facebook".

Kosova dhe Serbia zhvillojnë dialog me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian, që e mbështet edhe ShBA-ja. Dialogu thuhet se ka për qëllim që të përmbyllet me një marrëveshje ligjërisht të obligueshme. Por, palët kanë qëndrime të kundërta sa i përket përfundimit të procesit që ka nisur më 2011. Përderisa Kosova kërkon që një marrëveshje përfundimtare ta përfshijë njohjen reciproke, Serbia kërkon një zgjidhje kompromisi, pa specifikuar se për çfarë kompromisi bëhet fjalë.

Moisiu: Kalova shtatë porta për të shkuar te Thaçi, më erdhi rëndë kur e pashë atje

PRISHTINË, 5 JANAR - Ish-presidenti i Shqipërisë, Alfred Moisiu, ka komentuar takimin me ish-presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi, i cili ndodhet në burg në Hagë, ku është duke u zhvilluar procesi gjyqësor ndaj tij në Gjykatën Speciale. Moisiu tha se burgu ku rrinte Thaçi ishte me shtatë porta, ndërsa shtoi se i erdhi rëndë kur pa një ish-president të mbyllur atje. "Ai ishte një burg me 7 porta, me çelësa të ndryshëm, njëri i mbyllte e tjetri i hapte. Pra një burg me siguri të jashtëzakonshme. Më erdhi shumë rëndë kur pashë një ish-president të mbyllur atje. Të

shikoje këta njerëz që sakrifkuan jetën dhe familjen e tyre, gjithçka që kishin, vunë kokën në rrezik. Ata mbaheshin mirë, me kurajë, kishin besim te drejtësia, por unë për veten time nuk kam shumë besim. Kjo është për t'ua bërë qejfin serbëve. Në periudhën e luftës në shkollë bënim mbledhje klandestine dhe gjithmonë na thuhej çdo bëhet me Kosovën sepse armiku është i përbashkët. Në shkollat shqiptare në vitet '36-'37 ne këndonim për Kosovë e Çamëri, ja vdekje ja liri. Pra ishim edukuar për të kërkuar llogari se përse këta njerëz janë atje dhe jo këtu me ne", ka deklaruar Moisiu për "Euronews Albania".





Vuçiçi paralajmëron nëntë çnjohje, shoqëria civile dhe opozita të shqetësuara me heshtjen e Gërvallës

Shoqëria civile dhe opozita janë shprehur të shqetësuara me heshtjen e ministres së Punëve të Jashtme, Donika Gërvalla, pas paralajmërimit të presidentit të Serbisë Aleksandër Vuçiç, se nëntë shtete e kanë tërhequr njohjen e Kosovës. “Ajo që më shqetëson është heshtja e Ministrisë së Punëve të Jashtme”, ka thënë ish-ambasadorja e Kosovës në Uashington, Vlora Çitaku. E profesori universitar Fadil Maloku ka theksuar se si qytetar i thjeshtë dëshiron të dijë nga ministrja Gërvalla se çfarë është duke ndërmarrë Ministria e Punëve të Jashtme në lidhje me këtë paralajmërim për çnjohje

**EPOKA
ERE****Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 5 JANAR - Presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiç, në një konferencë për medie më 4 janar ka thënë se është duke pritur nga shteti i dhjetë që, sipas tij, ta tërheqë njohjen e pavarësisë së Kosovës. Ai nuk specifikoi se për cilin shtet bëhet fjalë.

Vuçiçi pretendoi se nëntë shtete veçse kanë tërhequr njohjen e Kosovës: Somalia, Burkina Faso, Gaboni, Esvatini, Libia, Guinea, Antigua dhe Barbuda, Shën Lucia dhe Maldivet. Sipas Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës janë 106 shtete që deri më tani e kanë njohur pavarësinë, që autoritetet e Kosovës shpallën më 2008. Ndërkaq në listën e publikuar në MPJD janë të listuara 117 njohje. Serbia edhe në të kaluarën ka

pretenduar se shtete të ndryshme kanë tërhequr njohjen e Kosovës, ndërkaq në bazë të marrëveshjes që palët arritën në Shtëpinë e Bardhë më 4 shtator 2020, Serbia ishte pajtuar që për një vit t'i ndalonte përpjekjet për të lobuar kundër



pavarësisë së Kosovës, ndërkaq Kosova ishte pajtuar që brenda kësaj periudhe të mos aplikonte për anëtarësim në ndonjë mekanizëm apo institucion ndërkombëtar.

Edhe pas skadimit të këtij moratoriumi, Shtetet e Bashkuara u kanë bërë thirrje palëve ta vazhdojnë respektimin e tij. Ndaj deklaratës së Vuçiçit për tërheqjen e njohjeve ka pasur reagime nga opozita dhe shoqëria civile.

Ish-ambasadorja e Kosovës në Uashington, tash nënkryetare e PDK-së, Vlora Çitaku, ka theksuar se nga përvoja gjithmonë duhen marrë me rezervë deklaratat nga Beogradi, mirëpo ajo thotë se e shqetëson heshtja e Ministrisë së Punëve të Jashtme. “Në raport me Kosovën ata vazhdimisht synojnë të

Ambasada Amerikane: Pavarësia e Kosovës është fakt

Ambasada Amerikane në Prishtinë tha se qëllimi i Shteteve të Bashkuara është që ta mbështesë Kosovën që të bëhet pjesë e strukturave evropiane dhe euroatlantike, duke theksuar se “pavarësia e Kosovës është fakt”.

Ky reagim në “Twitter” vjen pas një lajmi se llogaria e Ambasadës Amerikane në këtë rrjet social kishte “pëlqyer” një postim të një medie serbe që fliste për çnjohjet e pavarësisë së Kosovës, të pretenduara nga presidenti serb Aleksandër Vuçiç.

“Llogaria zyrtare në ‘Twitter’ e Ambasadës Amerikane nuk e ka ‘pëlqyer’ qëllimshëm asnjë postim në ‘Twitter’ në 24 orët e fundit. Siç e kemi thënë edhe më herët, kur ne duam të artikulojmë një qëndrim, ne e bëjmë përmes kanaleve zyrtare, deklaratave e jo përmes ‘pëlqimeve’ në rrjetet sociale”, thuhet në sqarim.

Ambasada shtoi se kundërshton në mënyrë kategorike “çdo përpjekje për të vënë në pikëpyetje pavarësinë dhe sovranitetin e Kosovës”.

krijojnë mjegull dhe huti. Çka thonë eksponentët në Beograd nuk e trajtoj kurrë si të mirëqenë. E di çka kanë thanë për mua dhjetëra herë. Veç aliene nuk më patën bërë. Mirëpo ajo që më shqetëson është heshtja e Ministrisë së Punëve të Jashtme. Sigurisht unë e kuptoj natyrën e punës dhe diskrecionin që ndonjëherë ta imponojë diplomacia. Po një përgjigje duhet dhënë”, ka shkruar Çitaku në “Facebook”. Opinioni Imer Mushkolaj ka pyetur nëse ministrja e Jashtme, Donika Gërvalla, di nëse ndonjë shtet e ka tërhequr njohjen e Kosovës. “A mundet me na tregu

Donika Gërvalla a e ka tërhequr zyrtarisht ndonjë shtet njohjen e Kosovës? Nëse jo, a mundet me i demantu pretendimet e Beogradit? Apo, si zakonisht, s’ka përgjigje, s’ka transparencë, ka veç heshtje”, ka shkruar Mushkolaj në “Facebook”.

Edhe politologu Albinot Maloku ka reaguar për paralajmërimin e Serbisë për çnjohje të Kosovës. Maloku ka shkruar në “Facebook” se hiç nuk e çuditë paralajmërimi i Serbisë për angazhimin e tyre për çnjohjet që mund t’i vijnë Republikës së Kosovës nga vendet njohëse. Ai ka thënë se MPJ do të duhej t’i ruajë njohjet, por edhe t’i shtojë

A rrezikon Evropa ta humbasë rëndësinë e saj në këtë shekull?

Bashkimi Evropian ndodhet larg autonomisë strategjike. Megjithatë, në një botë krizash dhe me rënien e mbështetjes së ShBA-së, ajo do të jetë më e pavarur. Por duket se është më e lehtë të flitet për autonomi në BE sesa të bëhet realitet

PRISHTINË, 5 JANAR - Në Berlin dhe Bruksel u dëgjua një psherëtimë lehtësimi, kur në nëntor u bë i ditur rezultati i zgjedhjeve të ndërmjetme në ShBA. Kalimi i pushtetit te republikanët në Kongresin Amerikan nuk doli aq sa pritej dhe ish-presidenti amerikan Donald Trump është më i dobët pas këtyre zgjedhjeve.

Nën Donald Trumpin marrëdhëniet transatlantike u ftohën, por evropianët nuk duhet të gëzohen shpejt, thotë Thorsten Benner, drejtor i Institutit "Global Public Policy" në Berlin.

Në një koment për "Deutsche Welle"-n, Benner shkroi se "Joe Bideni me gjasë do të hyjë në histori si transatlantiku i fundit". Epoka e mbështetjes zemërgjerë në politikën e sigurisë ka marrë fund pavarësisht se kush zgjidhet president në të ardhmen në Shtëpinë e Bardhë, kjo sepse në të ardhmen ShBA-ja do të përqendrohet shumë më tepër te Kina.

Autonomia strategjike, pjesë e programit qeveritar të Berlinit

Një ShBA që shkëputet ngadalë nga Evropa, një Kinë si fuqi botërore gjithnjë e më agresive, një Rusi e Putinit që sulmon një shtet të pavarur pa arsye - kjo është situata gjeopolitike në të cilën gjenden evropianët. Lufta në Ukrainë erdhi papritur gati për të gjithë, por zhvillimet e tjera jo. Në BE dhe kryeqytetet e tjera evropiane janë nxjerrë ndërkohë konkluzionet: përgjigja ndaj këtyre zhvillimeve është përmblendur në shprehjen "autonomi strategjike" që nënkupton që BE-ja duhet të veprojë e pavarur nga fuqitë e tjera botërore në aspektin politik, ushtarak, dhe ekonomik.

Josep Borrell, i ngarkuari për Politikën e Jashtme të BE, në një analizë për Evropën ka shkruar, se Evropa kërcënon të "humbasë rëndësinë". Ai e argumenton këtë me rënien e peshës politike të

Evropës në botë. "Para 30 vjetësh një çereku i mirëqenies botërore ishte në kontinentin tonë. Pas 20 vjetësh pjesa jonë në kapacitetin ekonomik botëror do të përfshijë më së shumti 11%. Autonomia strategjike është "çështje e mbijetesës" për BE.

Edhe në marrëveshjen e koalicionit të qeverisë gjermane të vitit 2021 theksohet se "duam të rrisim sovranitetin strategjik të Evropës (...) Qëllimi ynë është një BE sovraane si aktore e rëndësishme në një botë të përcaktuar nga pasiguria dhe konkurrenca e sistemeve."

Kritika ndaj vetëkënaqësisë gjermane

Por në cilën fazë ndodhen BE-ja dhe Gjermania përgjatë kësaj rrugë? European Council on Foreign Relations, (ECFR) publikon indeksin e sovranitetit evropian që mat sovranitetin në fushën e mbrojtjes, ekonomisë, shëndetit, migracionit, teknikës dhe klimës konstaton një masë të madhe sovraniteti në drejtim të ekonomisë dhe shëndetit, jep vlerësim të kënaqshëm në drejtim të mbrojtjes, klimës dhe migracionit. Problematike duket fusha e teknologjisë. Në këtë pikë BE është shumë e varur. Në qershor 2022 u mat çdo vend evropian dhe se çfarë kontribuon në sovranitetin e Evropës. Gjermania ka dalë më mirë në këtë hulumtim të ECFR, për shkak se është e fuqishme në shumë sektorë dhe investon në "aftësinë vepruese të Unionit" dhe publikisht kërkon sovranitet evropian.

Por një minus të madh e ka edhe Gjermania: Megjithë fuqinë ekonomike, në drejtim të kontributit për sovranitetin evropian ky vend renditet i pesti. Në hulumtim thuhet se kjo "reflekton pjesërisht vetëkënaqësinë gjermane në drejtim të varësisë nga Rusia dhe Kina". Autorët e studimit janë të mendimit, se Gjermania duhet ende të mësojë nga gabimet e së shkuarës.

ato. "Vitin që lamë nga guximtarët u tha se politika e jashtme e Kosovës 'nuk ka qenë asnjëherë më aktive, më e koordinuar e më kuptimplote', sesa tani! E kjo ka qenë me u çudit, nëse veç ka ngel ndonjë gjë me u çudit më garniturën aktuale drejtuese të vendit. Aktivë, po veç në ç'kuptim?! E koordinuar me kë? E

kuptimplote për çka?! Lëmshi nën yryshin e ndryshimeve në MPJ ka bërë që të hupë nga agenda nevoja për politikë të jashtme të dobishme, e cila jo veç që do të duhej t'i ruaj njohjet por edhe t'i shtojë ato. Ama, edhe cilat janë ato ndryshime nuk di kush! Lëmsh hesapi. Kryesorja RTSH e ka shpallur grua e suksesshme të '22-s



© Ute Grabowsky/photothek/picture alliance

Jo të gjithë në Evropë me të njëjtin qëllim

Evropa është ende larg arritjes së autonomisë strategjike, është i mendimit Henning Hoff nga Shoqata Gjermane për Politikën e Jashtme. "Në politikën e mbrojtjes dhe sigurisë, këtë e tregoi sulmi rus ndaj Ukrainës, evropianët janë të varur nga amerikanët." Kjo vlen si për kërcënimin nuklear, si edhe për forcat e armatosura konvencionale. "Nuk ka dyshim: Nëse Ukraina do të ishte varur tek Evropa, sot ky vend nuk do të ekzistonte më".

Presidenti francez Emmanuel Macron kërkon pavarësim të Evropës në çështjet ushtarake. Franca është i vetmi vend në BE me armë atomike pas largimit të Britanisë së Madhe nga BE. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg në fillim të dhjetorit në Konferencën e Sigurisë të Berlinit ka paralajmëruar nga një pavarësim evropian në politikën e mbrojtjes. "Unë nuk besoj tek 'Evropa vetëm' dhe as tek 'Amerika vetëm', tha ai. Vetëm NATO mund të garantojë sigurinë. Ai kujtoi se vendet e BE japin vetëm 20 % të shpenzimeve të mbrojtjes në NATO; 80 % vijnë nga ShBA, Britania e Madhe, Kanadaja apo Turqia.

Evropianët, po ashtu, janë të përcarë, kur vjen fjala për autonominë ushtarake: nëse do të pyeteshin vendet baltike dhe Polonia, duhet që ShBA dhe NATO të luajnë një rol të fuqishëm në Evropë. Mihai Chihaija nga instituti

i Brukselit, European Policy Center beson, se interesat e ndryshme janë të pajtueshme. "Një BE më e aftë do të kontribuonte në sigurinë transatlantike dhe do të plotësonte NATO-n".

Interesat e Kinës për portet

Në drejtim të autonomisë strategjike nuk bëhet fjalë vetëm për sigurinë dhe mbrojtjen. Politika e tregtisë dhe e industrisë, financat dhe investimet janë po ashtu me rëndësi. Evropianët kanë mbajtur lart multilateralizmin dhe tregtinë e lirë, edhe kundër Trumpit. Por ndërkohë edhe Josep Borrell e pranon, se "mpleksja ekonomike do të jetë shumë konfliktuoze në anën politike": në kohën e pandemisë u ndërpreu rrytet e furnizimit; Kina krijon me vetëdije varësi; Rusia mund të ndalë kur të dojë rubinetin e gazit. Tek sektorët që duhen mbrojtur veçanërisht në marrëveshjen gjermane të koalicionit bën pjesë furnizimi me energji. Se sa e varur është Gjermania në këtë pikë e tregoi lufta e Ukrainës. Po sot? A ka mësuar Gjermania? Kritikët e akuzojnë kancelarin Scholz, se ai pa nevojë lejoi marrjen e pjesës të terminalit të portit të Hamburgut nga një firmë kineze, Cosco, duke u futur në varësi. "Pikërisht këtu nevojitej një përgjigje evropiane më mirë, si për shembull një "iniciativë evropiane e portit", që do të siguronte që firmat kineze nuk ia kundërvënë njëri-tjetrit portet, ose bëjnë presion", thotë studiuesi Henning

Hoff. Nga ana tjetër pas kësaj qeveria gjermane refuzoi dy investitorë kinezë që donin të blinin sipërmarrje elektronike gjermane.

Pakënaqësi gjermano-franceze

Tradicionalisht Gjermania dhe Franca ndjehen si partnerë të ngushtë, edhe në drejtim të autonomisë strategjike. Si Gjermania ashtu edhe Franca e shikon veten "si promotore të autonomisë strategjike evropiane", sidomos në drejtim të mbrojtjes. Por pikërisht këtu ka probleme. Në projektin e përbashkët të avionëve luftarakë, FCAS të dyja palët ecin shumë ngadalë përpara. Edhe në projekte të tjera ka zhgënjime. Hoff kritikon, që qeveria gjermane nuk e merr sa duhet parasysh që "ajo që mendohet se është veprim vetjak kombëtar në të vërtetë ka gjithmonë pasojë evropiane, dhe duhet të koordinohet gjithmonë me Francën". Sipas tij Scholz nuk e ka gjetur rolin e tij në skenën evropiane. Nëse nuk shuhen mospajtimet në marrëdhënien gjermano-franceze, atëherë do të jetë shumë më e vështirë arritja e autonomisë evropiane".

E gjithë BE ka një rrugë të gjatë përpara në këtë drejtim, shprehet Mihai Chihaija nga European Policy Centre në Bruksel. "Objektivi është realist, dhe besoj, se nëse do të përballemi me problemet aktuale të sigurisë, nuk të mbetet gjë tjetër, veçse të kesh këtë objektivi". / DW

kryeguximtarën", ka shkruar Maloku.

Profesori universitar, Fadil Maloku, ka thënë se si qytetar i thjeshtë dëshiron të dijë nga ministrja Gërvalla se çfarë është duke ndërmarrë Ministria e Punëve të Jashtme në lidhje me këtë paralajmërim për çnjohje. "Ju lutem, si qytetar i thjeshtë i kësaj republike, e kam të drejtën

të pyes: Çfarë është duke ndërmarr Ministria e Punëve të Jashtme që ju e drejtoni, në lidhje me 'ofensivat' serbe për çnjohje? Serbia, dhe kryediplomacia e saj ka shumë kohë që ka paralajmëruar për reduktimin e njohjeve që (na i sollën aleatët) ishin mbi 106! Ndërkaq, tani ky numër do të zbres në 96!?", ka reaguar Maloku.

Ai ka shtuar se nëse e keni disponuar si të saktë informacionin për aktet dhe faktet e çnjohjeve pse nuk keni ndërmarrë asgjë për t'i zbrapsur, ose të paktën të sjellë ndonjë njohje të re. "Çka bëjnë gjithë ajo eskortë 'ekspertësh' që sillen vërdallë me mini çanta 'ekspertizash', rreth teje!?", ka thënë profesor Maloku.

Vazhdon rritja e çmimeve të produkteve bazike edhe këtë vit

PRISHTINË, 5 JANAR - Shtrenjtimi i produkteve bazike ka vazhduar edhe në fillim të vitit 2023. Nga 31 dhjetori i vitit 2022 deri më 3 janar të vitit 2023 shumë çmime kanë pësuar rritje. Sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave (ASK), mbi

çmimin ditor të produkteve, figuron se shtrenjtim ka pasur te mishi, sheqeri dhe benzina. Përveç këtyre, çmimet e tyre janë rritur edhe patatet, çaji, kripa e kuzhinës, detergjentet dhe shampunët.

Një kilogram çaj është

shtrenjtuar për 77 centë, sheqeri për 17 centë dhe një litër benzinë për 5 centë. Ndërkohë produktet që janë liruar janë orizi, makaronat, mielli, qumështi, djathi, gjiza, vaji, fasulja, të cilat janë liruar nga 1 deri jo më shumë se 10 centë.



Hamza takon të dërguarin e posaçëm të Britanisë, temë diskutimi siguria në Mitrovicë



MITROVICË, 5 JANAR - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, së bashku me nënkryetarin Arian Tahiri, kanë pritur në takim të dërguarin e posaçëm të Mbretërisë së Bashkuar për Ballkanin Perëndimor, Lord Stuart Peach, ambasadorin e Britanisë së Madhe në Kosovë, Nicholas Abbott dhe bashkëpunëtorët e tyre.

Temë kryesore e diskutimit në këtë takim ishte çështja e sigurisë së përgjithshme në vend, posaçërisht në Mitrovicë.

Hamza ka shprehur mirënjohje për bashkëpunimin e ngushtë dhe

përkrahjen e vazhdueshme të Ambasadës së Britanisë dhe popullit britanik për vendin tonë.

Ai është zotuar se do ta vazhdojë angazhimin e tij me të gjitha institucionet dhe komunitetet të cilave u shërben, pa dallim, për ruajtjen e paqes, stabilitetit dhe zbatimin e ligjshmërisë në vend.

Ndërkaq i dërguari i posaçëm i Mbretërisë së Bashkuar për Ballkanin Perëndimor, Lord Stuart Peach, ka falënderuar kryetarin Hamza për mikpritjen dhe leadershipin e treguar në ruajtjen e qetësisë dhe sigurisë.

Kosova ia lejon vizitën Patriarkut Porfirije



PRISHTINË, 5 JANAR - Patriarkut të Kishës Ortodokse Serbe, Porfirije, i është lejuar të zhvillojë vizitë në Kosovë në kuadër të përgatitjeve për festën e Krishtlindjes Ortodokse që festohet më 7 janar. Zyra e kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, ka bërë me dije se kreu i qeverisë iu përgjigj pozitivisht kërkesës për lejimin e vizitës së Porfirijes.

Këtë kërkesë Kurtit ia dërgoi ministri për Kthim dhe Komunitete, Nenad Rashiç. "Patriarku Porfirije ka paralajmëruar që sot pasdite do të vijë te vendkalimi kufitar ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe se dëshiron të hyjë pa truprojat e tij, edhe pse nuk ka bërë kërkesë për vizitë, sipas dispozitave të marrëveshjes ekzistuese", u tha në njoftim. Sipas qeverisë, paralajmërimi i Porfirijes se do të hyjë në Kosovë pa truproje është "edhe një dëshmi e radhës se Kosova është vend më i sigurt se Serbia".

Patriarku Porfirije kishte planifikuar ta vizitonte Kosovën edhe

në fund të dhjetorit. Megjithatë, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës e Kosovës, i kishte parashtruar disa kushte para se t'i lejohej vizita në Kosovë.

MPJD atëbotë tha se Porfirijes iu kërkua t'i dënojë apo të distancohet nga "veprimet e pjesëtarëve të Kishës që po u ofrojnë përkrahje grupeve kriminale në veri të Kosovës" të cilët ishin "përgjegjëse për barrikatat" e ngritura në atë pjesë.

Më pas, zyrtarët serbë deklaruan se kreu të Kishës Ortodokse Serbe iu ndalua hyrja në Kosovë përmes pikëkalimit kufitar të Merdarit.

Porfirije kishte planifikuar të qëndronte në Kosovë nga 26 deri më 28 dhjetor 2022, në kohën kur tensionet midis Kosovës dhe Serbisë ishin të larta, pasi grupe serbësh lokalë kishin ngritur barrikada në pjesën veriore të vendit, të banuar me shumicë serbe.

Më 28 dhjetor serbët vendosën t'i largonin barrikatat pasi argumentuan se kërkesat e tyre për një gjë të tillë ishin plotësuar.

Çmimi i naftës në Kosovë pritet të stabilizohet në mars

PRISHTINË, 5 JANAR - Po raportohet se çmimet e naftës në botë kanë rënë si para luftës në Ukrainë, ndërsa një gjë e tillë në Kosovë nuk është vënë re. Kryetari i Shoqatës së Naftëtarëve të Kosovës, Fadil Berjani, për RTV 21 ka bërë me

dije se çmimet dhe tregu i derivateve pritet të stabilizohen nga muaji mars. "Çmimet dhe tregu pritet të stabilizohet nga muaji mars, sipas informatave nga organizata prodhuese OPEC", ka thënë Berjani.

Në fillim të vitit 2023 çmimi i dizelit për litër është 1.43 centë, ndërsa i benzinës 1.30 centë.

Çmimet dhe kërkesa për naftë janë rritur në tregjet ndërkombëtare pas ndërhyrjes ushtarake të Rusisë në Ukrainë në shkurt të vitit 2022.



Varroset Papa Benedikti XVI

Mijëra persona u mblodhën të enjten në sheshin "Shën Pjetri" për varrimin e Papës Emeritus Benedikti XVI, teologut gjerman, i cili bëri histori duke u tërhequr nga drejtimi i Kishës Katolike



VATIKAN, 5 JANAR - Në Vatikan, përmes një ceremonie kishtarë, është varrosur Papa Benedikti XVI, i cili vdiq më 31 dhjetor në moshën 95-vjeçare.

Mijëra persona u mblodhën në sheshin "Shën Pjetri" për varrimin e Papës Emeritus Benedikti XVI, teologut gjerman, i cili bëri histori duke u tërhequr nga drejtimi i Kishës Katolike.

Ceremoninë e varrimit e udhëhoqi Papa Françesku.

Gjatë ceremonisë Papa Françesku përmendi fjalët e fundit të Krishtit: "Atë, në duart tuaja ta dorëzoi shpirtin tim".

Ai tha se besimtarët urojnë të njëjtën gjë për Benediktin. "Duke u mbështetur në fjalët e fundit të Zotit dhe si dëshmitarë të gjithë jetës së tij, edhe ne, si komunitet kishtar, duam t'i ndjekim hapat e tij dhe t'ia dorëzojmë shpirtin e vëllait tonë në duart e Atit".

Ai përfundoi duke thënë: "Ne të gjithë së bashku duam të themi, Atë në duart tuaja ta dorëzojmë shpirtin e tij. Benedikt, mik besnik

i Krishtit, qoftë i plotë gëzimi yt teksa ti dëgjon zërin e tij, tani dhe përgjithmonë".

Pas ceremonisë në sheshin "Shën Pjetri", ka nisur shërbesa private në bazilikën e Vatikanit. Sipas autoriteteve, ceremoninë sheshin "Shën Pjetri" në Vatikan e kanë ndjekur deri në 100 000 persona.

Në këtë ngjarje morën pjesë krerë të shteteve dhe përfaqësues të mbretërive, pavarësisht se Benedikti kishte kërkuar që varrimi i tij të mos ishte një ngjarje e madhe. Vetëm Italia dhe Gjermania ishin ftuar që të dërgojnë delegacione zyrtare dhe presidenti gjerman, Frank-Walter Steinmeier dhe ai italian, Sergio Mattarella, kanë konfirmuar pjesëmarrjen e tyre.

Përveç tyre, në ceremoninë e varrimit u ftuan edhe krerë e disa qeverive, katër kryeministra dhe dy delegacione të familjeve mbretërore. Po ashtu, në ceremoninë e varrimit mori pjesë edhe ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës të

Kosovës, Donika Gërvalla, së bashku me përfaqësuesin e Kosovës për Selinë e Shenjtë, Vehbi Miftari.

Sipas ritit të varrimit, arkivoli i Benediktit u dërgua nga bazilika dhe u vendos para altarit, ndërsa besimtarët thanë lutje kishtarë. Ky ritual është i bazuar në kodin që është përdorur edhe për papët e tjerë që kanë vdekur, por në këtë rast janë bërë disa modifikime, pasi Benedikti nuk ishte papë në detyrë kur vdiq.

Pas meshës, arkivoli prej qiparisi i Benediktit u vendos brenda një arkivoli prej zinku, më pas në një arkivol të punuar me dru lisi dhe do të varroset në varrezat që gjenden nën bazilikë, ku dikur gjendej edhe varri i Papa Gjon Palit II. Më pas, arkivoli i Benediktit do të zhvendoset në katin e sipërm në bazilikën kryesore.

Afër 200 000 persona bënë nderime para arkivolit të Benediktit gjatë tri ditëve të kaluara më Bazilikën e Shën

Pjetrit.

Ish-kreu i Kishës Katolike, emri i vërtetë i të cilit ishte Joseph Ratzinger, vdiq më 31 dhjetor në moshën 95-vjeçare. Ai konsiderohej si një prej teologëve më të mirë të shekullit XX dhe e kaloi jetën e tij duke iu përmbajtur doktrinës së Kishës.

Benedikti do të mbahet mend në histori për një akt të veçantë e revolucionar që ndryshoi të ardhmen e papatit. Ai u pensionua duke u bërë papa i parë në gjashtë shekuj që u tërhoq nga drejtimi i Kishës Katolike.

Papa Françesku e ka vlerësuar lart kurajën e Benediktit për t'u tërhequr në momentin kur ai besoi se nuk kishte më fuqi për ta udhëhequr Kishën. Sipas Françeskut, ai "hapi derën" që edhe papët e tjerë ta bëjnë të njëjtën gjë.

Françesku tha se për vete ka lënë udhëzime të shkruara për kushtet, në të cilat ai po ashtu do të jepte dorëheqje nëse nuk do të ishte i aftë ta vazhdonte punën.

Benedikti u zgjodh papë më 2005 në moshën 78-vjeçare dhe u bë papa më i vjetër që u zgjodh në krye të Vatikanit. Ai udhëhoqi Kishën për pothuajse tetë vjet dhe më 2013 dha dorëheqje. Ai u bë Papa i parë që u dorëhoq që nga viti 1415, kur nga drejtimi i Kishës ishte tërhequr Gregori XII.

Trashëgimia e Papa Benediktit u dëmtua nga skandalet për abuzim seksual nga priftërinjtë. Më herët gjatë këtij viti Benedikti pranoi se kishte bërë gabime gjatë trajtimit të rasteve të abuzimit kur ai ishte kryepeshkop i Munihut gjatë viteve 1977-1982.

Ai kërkoi që priftërinjtë që përdhunonin fëmijë të ndëshkoheshin nga Selia e Shenjtë. Si kardinal dhe papë, ai miratoi legjislacione që rezultuan me shkarkimin e 848 priftërinjve nga viti 2004 deri më 2014. Megjithatë, të mbijetuarit e abuzimeve e mbajtën atë përgjegjës për skandalin dhe e akuzuan atë se kishte dështuar t'i sanksiononte peshkopët.



Shqipëri, bizneset mes vështirësive për të tretin vit me radhë

TIRANË, 5 JANAR - Në Shqipëri sektori i biznesit ka mbyllur vitin e tretë të vështirë pas goditjeve të njëpasnjëshme të tërmetit të vitit 2019, pandemisë së koronavirusit, 2020-2021, dhe agresionit rus në Ukrainë, në shkurt të vitit që lamë pas, që tronditi gjithë ekonominë botërore. Për pasojë çmimet e lëndëve të para u rritën me dy deri në tri herë, duke sjellë edhe rritje të kostove të prodhimit.

Përfaqësues të sipërmarrjes private thonë se janë ndier në vështirësi të mëdha dhe se nuk e gjeten veten të mbështetur me paketa subvencionuese nga qeveria sikundër ndodhi në vende të tjera.

Inflacioni mesatar për vitin 2022 ishte rreth 7 për qind, ose rreth dy herë më shumë se para fillimit të luftës në Ukrainë. Por ndonëse rënduan

konsumatorët, çmimet më të larta sollën 14 për qind, ose rreth 500 milionë euro më shumë të ardhura në buxhet se një vit më parë.

Përfaqësues të sipërmarrjes thonë se këto të ardhura duhet të kthehen sërish te qytetarët dhe biznesi përmes paketave mbështetëse. "Ka një tepricë të ndjeshme të të ardhurave për vitin 2022. Minimumi është që kjo tepricë duhej t'i kthehej sipërmarrjes dhe qytetarëve shqiptarë. Një gjë të tillë e kanë bërë të gjitha vendet e BE-së dhe jo vetëm kaq, por kanë përfshirë edhe paketa subvencionuese në mbështetje të sipërmarrjes për ta mundësuar lehtësimin e kalimit të krizës", u shpreh për

"Zërin e Amerikës" Nikolin Jaka, kryetar i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë në Tiranë.

Por zyrtarët qeveritarë bëjnë llogari të tjera kur bëhet fjalë për të ardhurat e shtuara në buxhet, kryesisht nga rritja e çmimeve.

"Shumica e publikut e mendon në formën e thjeshtë, që ka më shumë të ardhura dhe këto fonde janë atje shtesë, si tepricë, por nuk është kështu. Gjatë këtyre dy vjetëve, për shkak të rolit shtesë që mori qeveria për pandeminë dhe procesin e rindërtimit, borxhi publik është rritur. E para janë kostot shtesë që duhen mbuluar, e dyta janë dhe kostot e marrjes së huas me normat e interesit ndërkombëtar që janë rritur. Për ta mbajtur procesin fiskal dhe makroekonomik të pandryshuar është e nevojshme që borxhi të mbahet nën kontroll dhe të ulet në mënyrë që vitet e ardhshme në rast se kemi goditje negative, të jemi në kushte optimale për t'i ardhur në ndihmë ekonomisë", është shprehur Besart Kadia, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë.

Për ta amortizuar krizën Qeveria e Shqipërisë miratoi gjatë vitit të shkuar dy paketa të rezistencës sociale për shtresat në nevojë. Pensionet u indeksuan me 9.5 për qind, pagat për disa kategori u rritën me 7-15 për qind dhe mbështetja financiare në total arriti rreth 360 milionë euro, ku pjesën kryesore e mbajti subvencionimi i çmimit të energjisë elektrike me rreth 280 milionë euro. Çmimi i energjisë u liberalizua pjesërisht vetëm



për biznesin e lidhur me tensionin e mesëm.

Zyrtarët thonë se subvencionimi i energjisë elektrike për biznesin si dhe mbajtja e taksave të pandryshuara është një mbështetje optimale për sipërmarrjen private në kushtet e krizës, por përfaqësues të opozitës mendojnë se biznesi nuk pati mbështetje të mjaftueshme. "Biznesi duhej të kishte sistem taksash më të lehtë sot e kemi me 6 nivele. Përkundrejt kësaj qeveria synon ta prezantojë amnistinë fiskale, që rrit informalitetin. Duhej të kishim synuar ta rrisnim formalitetin, ndërkohë qeveria, duke prezantuar taksat të reja dhe duke e shtrënguar më shumë,

do ta rrisë informalitetin. Duhej të kishim pasur një strategji afatmesme për zhvillimin, por edhe për mbledhjen e të ardhurave", ka thënë për "Zërin e Amerikës" Jordia Tabaku, deputete e PD-së.

Duke iu referuar nismave financiare të qeverisë për rritjen e pagave për disa kategori në administratën publike, Tabaku sjell në vëmendje se sipërmarrja private, që ka numrin më të lartë të të punësuarve rreth 90 për qind, nuk ka pasur mundësi t'i rrisë pagat për shkak të krizës. Për pasojë punonjësit e sektorit privat, sipas saj, janë të pambrojtur përballë rritjes së çmimeve. Ndonëse inflacioni mesatar

për vitin 2022 ishte rreth 7 për qind mjaft ekspertë kanë ngritur shqetësime, se artikuj të domosdoshëm të shportës si vajrat, drithërat apo bulmeti, patën një rritje disa herë më të lartë se ajo e pagave dhe pensioneve dhe se kjo rëndoi së tepërmi buxhetin familjar. Madje dhe rritjen e dërgesave të emigrantëve me 10 për qind për periudhën janar - shtator 2022, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ata e shohin të lidhur me pamundësitë e familjeve për ta përballuar krizën pa ndihma nga të afërmit e tyre jashtë vendit. Zyrtarët qeveritarë thonë se është vështirë të kompensohet çdo shtresë shoqërore për të gjitha kostot e shportës.

Tahiri: Rezultati i kësaj qeverie, ikje e të rinjve dhe mungesë e investimeve



PRISHTINË, 5 JANAR - Kryetari i grupit parlamentar i PDK-së, Abet Tahiri, ka thënë se në vitin 2023 kemi hyrë me pasoja të retorikës së kryeministrit Kurti gjatë 2022-s. Ai ka theksuar se përderisa në Ukrainë luftohej agresioni rus, në Kosovë flitej për luftë nga kryeministri i vendit. Sipas Tahirit, nga kjo qeveri kemi këtë rezultat: ikje e të rinjve, mungesë investimesh, mungesë zhvillimi dhe mungesë perspektive. "Nga një histori suksesi e ngritje e një shteti modern, me retorikën e kryeministrit gjatë 2022-s, jemi rikthyer në lajme ndërkombëtare si një vend jostabil e me rrezik për konflikte. Ta mendosh se çfarë dëmi i ka bërë kjo Kosovës, do të thotë të kesh në mendje tre parametra: Cili investitor i huaj do të rrezikonte të

investonte në një vend, kryeministri i të cilit flet për luftën që na kanoset? Si mund të shpresojnë në perspektivë, të rinjtë e një vendi që qeveriset me një kryeministër të tillë? Çfarë e ardhmeje ekonomike e pret një vend, kryeministri i të cilit vizionin e vetëm e ka përballjen me luftën e tij?", ka shkruar Tahiri në "Facebook". Ai ka thënë se në fakt lufta ka qenë tema qendrore dhe preteksti në kokën e kryeministrit, i cili përmes saj ka abstenuar t'u përgjigjet betejave të përditshme sociale dhe ekonomike me të cilat ballafaqohen qytetarët e Kosovës. "Rezultati: ikje e të rinjve, mungesë investimesh, mungesë zhvillimi, mungesë perspektive. Vit i ri, me pasoja të një mentaliteti të vjetër", ka shkruar Tahiri.

VËSHTRIM PËR LIBRIN "GUXIMI, TRI DITË BASHKË PËR LIRI" I AUTORIT HABAB ZOGAJ

Album i guximit në luftë



Shefqete GOSALCI

Habib Zogaj, padyshim është një emër i njohur në shoqërinë shqiptare. Dikush mund ta ketë njohur nga ilegaliteti, dikush nga radio dhe televizioni, dikush nga raportimet nga zonat e luftës e shumëkush nga librat. Veprimtaria e tij atdhetare shquhet për ndjeshmërinë, përkushtimin, profesionalizmin dhe guximin. Ai me punë dhe seriozitet ka krijuar autoritet dhe ka lënë gjurmë kudo ku ka vepruar dhe punuar. Habib Zogaj, pavarësisht plagëve të luftës dhe të pasluftës, me ngulm vazhdon luftën me betejat e jetës, po me të njëjtin stoicizëm. Duke qenë njeri fisnik dhe modest, tipik shqiptar dhe atdhetar i devotshëm, me kulturë të lartë, ai është shembull dhe vlerë e shtuar e shoqërisë. Titulli i këtij libri, "Guximi, tri ditë bashkë për liri", i shkruar nga një shqiptar i denjë e guximtar, luftëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nga fshati Turjakë, Habib Zogaj, i cili në moshë shumë të re u angazhua në Lëvizjen Kombëtare dhe e kuptoi filozofinë politike, se pushtuesi nuk largohet nga vendi pa luftë të armatosur, mblodhi rreth vetes shumë vullnetarë, djem e vajza, burra e gra, për t'i dal Zot Atdheut, duke i dhënë kuptim shumëdimensional kësaj fjale. Autori shkruan: "Robërinë e

ndjente secili. Secili e ndjente shtrëngimin. Rinia e brumosur me ndjenjën e atdhedashurisë u ngrit ngadalë, kujdesëm dhe mençurisht për të bërë këtë detyrë. Në çdo mjedis ndjehej lëvizja. As vendbanimi ynë, Turjaka, nuk kishte fjetur. Po lëvizte diçka. Natën dhe ilegalisht të skutuar dhe me maska, por për qëllimin e mirë. Dhe u arrit qëllimi! Jo lehtë, por u arrit. Se si u arrit e dinë edhe këta djem që e bartën mbi kurrizin e tyre organizimin, armatimin, luftimet dhe sukseset në veprime konkrete, ashtu mu sikur ari, që në zjarr provohet". Të kesh guxim do të thotë ta kesh dhe ta ndjesh brenda vetes lirinë, të kesh besim e shpresë, të kesh frymën, ëndrrën e brumin, vullnetin e disiplinën, të kesh sekretin, motivin e shpirtin, përgjegjësinë e zotësinë, vuajtjen, mallin, dhembshurinë, djersën, vajin e gazin e përpjekjen e gjithë brezave shqiptarë që ëndërruan lirinë, të kesh pasionin dhe virtytin më të lartë njerëzor, të kesh atdhedashurinë e dijen, dhe të marrësh përsipër rrezikun për t'i ndryshuar gjërat në thelb, në aspektin pozitiv. Guximi, para së gjithash është vizion, është humanizëm, urtësi e veprim, është maturi dhe mirësi, vlerë, edukatë e kulturë, është jetë përtej vdekjes. Guximtari, me vetëdije shkon për të vdekur për të tjerët, edhe kur Zoti nuk e merr. Guximtari edhe i vdekur


është i gjallë. Të marrësh përsipër organizimin e luftës së armatosur në rrethana të një okupimi klasik siç ishte rasti i Kosovës, (që për disa konsiderohej utopi, duke e llogaritur Serbinë superfuqi ushtarake të Ballkanit), dhe të rekrutosh djem e vajza në radhët e UÇK-së, siç veproi autori i këtij libri në Turjakën e tij, ishte sipërmarrje e madhe e guximshme dhe shumë serioze. Demonstatat e vitit 1968, 1981,

1997, ishin nëse mund të them, maxhja ku u gatua brumi i UÇK-së. Ato ditë, ata njerëz kërkonin. Koha po kërkonte djem e vajza, gra e burra guximtarë, që morën mbi supë fatin e Kombit dhe me UÇK-në, përpjekjeve shekullore të Kombit tonë për liri e pavarësi po ia vendosnin kurorën. Lindja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në kapërcyellin e shekullit njëzetë, pas përpjekjesh titanike shekullore, të rënda e të mundimshme të Kombit shqiptar, për çlirim e bashkim kombëtar, të shoqëruara brez pas brezi me padrejtësi, pabarazi, përndjekje e tortura mizore, me burgosje e vrasje pa gjyq, nga regjimi totalitar i Serbisë, ishte Rilindje dhe Shkollë e madhe e kohës. Thënë me fjalë tjera, ne u zgjuam si Komb dhe morëm në duar fatin tonë. Nderime Atdheut- Liri Popullit, kështu komunikohet me popullin. Autori Zogaj, përmes librit "Guximi", sjell në kujtesë dhe vëmendje shumë emra të përveçëm të UÇK-së, që me gjak i lanë këto troje dhe i lan kokë e gjymtyrë gjithandej Kosovës, sjell shumë fotografi, dokumente e argumente dhe fakte kryeneçe që flasin bindshëm për bëmat, sakrificat, flijimet dhe heroizmat e atyre

njerëzve të asaj kohe që janë pasqyra dhe historia e ndritur e saj. Shumë prej këtyre emrave, djem atdhetarë e luftëtarë të paepur, të Togut të Turjakës, të Njësitit Ushtarak "Çeliku", të Turjakës, me Komandant Habib (Nezir) Zogaj, dhe zëvendëskomandant Adem E. Kastrati, Turjakës i dhanë emër dhe nder. Bazat (shtabet), në Turjakë: 1. Kulla e Liman (Avdi) Kastrati; 2. Lokali te Rexhep (Rexhep) Berisha; 3. Shtëpia e Ramadan (Bajram) Zogajt. Ushtria ishte popull dhe populli ushtri. (Disa nga luftëtarët: Adem E. Kastrati, Destan R. Kastrati, Qerim J. Zogaj, Muharrem Q. Kastrati, Gëzim H. Kastrati, Bekim H. Kastrati, Nuhi J. Zogaj, Daut M. Kastrati, Smajl R. Berisha, Ilir H, Bytyqi, Hazir R. Zogaj, Aziz A. Zogaj, Lavdim H, Kastrati, Ahmet Sh. Kastrati, Xhemë S. Kryeziu, Mehmet Gashi, Sejdi Berisha, Ahmet Berisha, Betim I. Kastrati etj.) Në themelet e guximit janë ndjenjat, gjaku, betimi, flamuri dhe vendimi.

Ky libër është një album i jetës, që kërkonte jetë. Guximtarët triumfojnë gjithmonë, dhe gjithmonë do të kemi nevojë për guxim. Lavdi e përjetshme martirëve, dëshmorëve e herojve të kombit!

(12.10.2022)



Në ditën e veteranit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, 30.12.2022 ,në Kuvendin Komunal të Malishevës u përurua libri "Guximi, tri ditë bashkë për liri", i autorit Habib Zogaj.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

FBK-ja ka prioritet zhvillimin dhe masivizimin e basketbollit 3x3

PRISHTINË, 5 JANAR - FIBA 3x3 Challenger Prishtina dhe FIBA 3x3 Womens's Series do të organizohen më 14, 15 dhe 16 korrik 2023 në Prishtinë. Të dy këto aktivitete do të organizohen nga klubi 3x3 Prishtina në mbështetje të Ministrisë për Kulturë, Rini dhe Sport të Kosovës (MKRS) dhe Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK). Kjo është hera e dytë me radhë që FIBA 3x3 Challenger Prishtina do të organizohet në kryeqytetin tonë, derisa do të jetë hera e parë që një garë e nivelit të lartë në konkurrencën e femrave në garat 3x3 siç është FIBA 3x3 Women's Series të organizohet në Prishtinë. Në FIBA 3x3 Challenger Prishtina do të marrin pjesë 12 ekipe nga jashtë vendi dhe 4 nga Kosova (përmes Wild Card).

FIBA 3x3 Challenger Prishtina do të jetë një prej 10 Challenger që organizohen në të gjithë botën. Ndërkaq FIBA 3x3 Women's Series është ngjarja numër 1 në basketbollin 3x3 të femrave. Edicioni i kësaj gare fillon në muajin maj dhe përfundon në muajin shtator, me turne të organizuar në 12 qytete të ndryshme të botës. "Për Federatën e Basketbollit të Kosovës zhvillimi i basketbollit 3x3 në të gjitha aspektet si në masivizim ashtu edhe në aspektin komercial është prioritet për vitin 2023 e më tutje. Federata e Basketbollit e Kosovës sivjet për herë të parë do të fillojë me organizimin e garave shkollore në basketbollin 3x3, ku do të startojë me 10 shkolla në 10 komuna, në formë të pilot-projektit duke i angazhuar rreth 25 mijë fëmijë qysh në vitin e parë, më pas për çdo vit do të shkojë duke u rritur numri i angazhimit të fëmijëve në shkolla në basketbollin 3x3", ka thënë Elvira Dushku, sekretare e përgjithshme e FBK-



së. Gjithashtu, FBK-ja planifikon të kandidojë në FIBA për organizimin e FIBA 3x3 U23 Nations League, por edhe të marrë pjesë me ekipin e meshkujve dhe femrave U23. "FIBA 3x3 U23 Nations League është një garë kombëtare e FIBA 3x3 për meshkuj dhe femra nën moshën 23 vjeç, që ka filluar të organizohet që nga viti 2017. Kjo garë ofron një mundësi të mirë për talentet e të ardhmes që t'i përmirësojnë aftësitë e tyre në përgatitjen

për kategorinë seniore dhe garat elitare siç janë FIBA 3x3 Kupa e Botës, Lojërat Olimpikë etj", ka shtuar Dushku. Federatat kombëtare që marrin pjesë në këtë garë duhet të regjistrojnë 1 ekip të meshkujve dhe 1 të femrave në çdo "stacion" të FIBA 3x3 U23 Nations League. Në FIBA 3x3 U23 Nations League marrin pjesë 12 ekipe (meshkuj/femra). FIBA 3x3 U23 Nations League 2022 përmban një rekord me pjesëmarrje të 57 federatave kombëtare në këtë garë.

Sfida kryesore në mes të Istogut dhe Vushtrrisë

PRISHTINË, 5 JANAR - Të premten do të zhvillohet xhiroja e 20-të në Ligën e Parë të meshkujve. Sfida kryesore do të zhvillohet në mes të Istogut dhe Vushtrrisë. Istogasi kanë 13 fitore e katër humbje, kurse vushtrriasit kanë 14 fitore e tri humbje, andaj pritet një përballje shumë interesante mes këtyre dy skuadrave. Takimi i parë i xhros zhvillohet mes skuadrave prishtinase, Prishtina e Re, që ka shtatë fitore e 11 humbje dhe Bora numëron 11 fitore e gjashtë humbje. Ndeshja e dytë zhvillohet ndërmjet AS Prishtinës dhe



Gjakovës së Re, ku prishtinasit kanë 17 humbje në po aq ndeshje të zhvilluara, ndërsa skuadra nga Gjakova ka shtatë fitore e dhjetë humbje. Happy Dukagjini do të ndeshet me Borean. Klinasit kanë pesë fitore e 12 humbje, kurse pejanët deri më tani kanë tetë fitore e dhjetë

humbje. Një nga kandidatet kryesore për të hyrë në "play-off", Drita, do të sfidohet nga Marigona Hill Prishtina. Skuadra gjilanasë numëron 13 fitore e katër humbje, kurse ajo prishtinase pesë fitore e 12 humbje.

SHKURT

Benjamin Agyare rikthehet te Drita

Benjamin Agyare është rikthyer te Drita pas huazimit katërmujor te Drenica. Lajmin e dhënë faqja zyrtare e klubit gjilanas në rrjetet sociale. "Benjamin Agyare rikthehet te klubi ynë pas një huazimi katërmujor te Drenica. Agyare kishte nënshkruar me ne në verën e vitit kaluar deri më 30.06.2025 dhe më pas u huazua te Drenica për të debutuar në Superligën e Kosovës", thuhet në njoftimin e skuadrës së Dritës.

Muriqi: Ta harrojmë fitoren, të shtunën na pret një ndeshje e rëndësishme

Sulmuesi i Përfaqësueses së Kosovës, Vedat Muriqi, ka shkëlqyer në të 16-n e finales së Copa del Rey duke e shënuar një gol dhe duke dhuruar një asistim në fitoren 2-0 ndaj Ponteverda CF. "E dinim se do të ishte një ndeshje e vështirë në një fushë të vështirë, por ne fituam dhe gjëja më e rëndësishme e kësaj loje ishte të kalonim në raundin tjetër. Tash duhet ta harrojmë këtë lojë sepse e kemi një lojë të madhe në shtëpi të shtunën. Jam sulmues dhe nëse shënoj dhe nëse ekipi im fiton, është e qartë se jam mjaft i lumtur", ka deklaruar Muriqi. Ndeshjen e radhës Mallorca e pret Valladolidin.

Muja, 'lojtar i muajit' tek Antwerpi

Futbollisti nga Kosova, Arbnor Muja, po kalon në një periudhë mjaft të mirë në Belgjikë. Ish-futbollisti i Dritës, Arbnor Muja, i cili u transferua këtë edicion te skuadra Antwerpen, ka arritur të marrë një çmim të rëndësishëm. Ai u shpall "lojtar i muajit" te skuadra belge. Muja deri më tani i ka dy paraqitje për Antwerpen. 24-vjeçari ka shënuar një gol dhe ka bërë dy asistime për ekipin e tij.

Napoli bën gati kontratën e re për Rrahmanin

Amir Rrahmani do të vijojë të jetë pjesë e Napolit. Paraqitjet e tij të mira në drejtuesit e Luciano Spalletti duket se i kanë bindur drejtuesit e klubit t'i besojnë Rrahmanit të ardhmen e mbrojtjes së skuadrës. Mbrojtësi i Kosovës pritet ta rinovojë kontratën deri në vitin 2027. Në stadium, ndodhet edhe agjenti i mbrojtësit, Ardian Aliaj, i cili do të takohet me drejtuesit e kaltër për të diskutuar për marrëveshjen. Sa i përket pagës së lojtarit, Rrahmani pritet të përfitojë nga kontrata e re rreth 2.6 milionë euro në sezon. Kontrata aktuale e mbrojtësit të Kosovës skadon në qershor të vitit 2024.

LIGA E PARË - JAVA 20

TË PREMTEN TAKOHEN:

- 12:15 Prishtina e Re - Bora
- 16:30 AS Prishtina - Gjakova e Re
- 17:00 Happy Dukagjini - Borea
- 18:30 Drita - Marigona Hill Prishtina
- 19:00 Istogu - Vushtrria

Rama premton ndërtimin e tre stadimeve të reja

TIRANË, 5 JANAR - Edhe pse Shqipëria i ka katër stadime moderne, të cilat mund të presin ndeshje ndërkombëtare në Tiranë, në Elbasan, në Shkodër dhe në Kukës, kryeministri Edi

Rama ka premtuar se në një të ardhme të afërt do të nisë ndërtimi i tri stadimeve të tjera. Kreu i qeverisë shqiptare e bëri premtimin e vitit të ri në mbledhjen e mbajtur të enjten.

Rama ka njoftuar se gjatë pranverës do të zhvillohen konkurset ndërkombëtare për Durrësin, Vlorën dhe Korçën, ku pritet të ndërtohen stadime moderne. "Tri stadime të reja

nisin me tri konkurse ndërkombëtare brenda pranverës, në Durrës, Vlorë dhe Korçë. Dhe 'Selman Stërmasin' me Bashkinë e Tiranës, besoj", ka shkruar Rama në "Facebook".



Golden State ndalet sërish, Lakersat dalin nga kriza

LOS ANXHELOS, 5 JANAR - Ndalet pas 12 fitoresh skuadra e Brooklynit, që u mund me rezultat 121-112 nga Chicago, në një ndeshje me mjaft emocione. Duranti realizoi 44 pikë, por që s'mjaftuan për ta evituar humbjen e Netsit, ndërkohë që tre lojtarë të Bullsit realizuan mbi 20 pikë (Vuqeviq 21 pikë e 13 rebounde). Fitorja e tretë radhazi për Lakersat, që synojnë një vend në "play-off". Kalifornianët mundën Miamin (112-109), një sfidë e vendosur në fund. Edhe pse nuk luajtën



LeBroni e Davisi, Lakersat fituan dhe ai që bëri diferencën ishte Schroder me 32 pikë, duke i bërë të pavlefshme 30 pikët e 13 reboundet e Adebayo. I zakonshmi Giannis Antetokounmpo shpëton Milwaukee nga humbja, duke realizuar një "triple double" (30

pikë, 21 rebounde e 10 asistime) në fitoren 104-101 ndaj Torontos. Skuadra kampione e Golden States u mund 121-119 në fushën e saj nga Detroiti (Bogdanoviq 29 pikë), ndërsa Memphis fitoi me rezultat 130-107 ndaj Charlottes (Morant 23 pikë), duke kapur kreun në Perëndim.

REZULTATET

Charlotte - Memphis	107-130
Cleveland - Phoenix	90-88
Orlando - Oklahoma	126-115
Philadelphia - Indiana	129-126
New York - San Antonio	117-114
Toronto - Milwaukee	101-104
Chicago - Brooklyn	121-112
Minnesota - Portland	113-106
New Orleans - Houston	119-108
Golden State - Detroit	119-122
Lakers - Miami	112-109
Sacramento - Atlanta	117-120

Mayweather rikthehet në ring në shkurt

USHINGTON, 5 JANAR - Boksieri amerikan Floyd Mayweather ka deklaruar se muajin e ardhshëm do të zhvillojë një tjetër sfidë "show", këtë herë në Britaninë e Madhe. Kjo do të jetë hera e parë që 45-vjeçari do të duellojë në këtë vend, ku asnjëherë në karrierën e tij nuk ka dueluar më parë. Mayweather, i tërhequr nga sporti profesionist në vitin 2017, nuk ka bërë me dije emrin e rivalit të tij. Prej disa vjetësh ai zhvillon duelle të tilla "show", kryesisht me personazhe të njohur, sfida nga të cilat arkëton milionë dollarë, nga sponsorët e të drejtat televizive. Hera e fundit që është ngjitur në ring ka qenë nëntori i vitit të kaluar, kur duelloi në Dubai. Gjithsesi, Mayweather nuk ka ndër mend të ndalet në këtë rrugëtim të ri që ka nisur. Madje ai po zgjeron hartën e shteteve ku



duelon, teksa për herë të parë do të duellojë në Angli. "Do të rikthehem në ring në muajin shkurt dhe do të zhvilloj një duel "show" për fansat e mi në Angli. Zgjodha këtë vend, pasi aty nuk

kam dueluar kurrë më parë si boksier profesionist. Shpresoj që në shkurt të realizoj këtë sfidë nëse do të jetë e mundur", ka thënë Mayweather, i pamposhtur në karrierë.

SHKURT

Guardiola: Nëse Arsenali vazhdon kështu nuk do ta kapim

Trajneri i Manchester Cityt, Pep Guardiola, ka thënë se skuadra e tij do të duhet të jetë pothuajse perfekte në mënyrë që të përfshihet në luftën për titull me Arsenalin. City aktualisht është i dyti në renditjen e Premierligës, tetë pikë prapa Arsenalit. "Mënyra për ta zvogëluar diferencën është të luash lojtarë të mira dhe të fitosh. Arsenali do të shënojë 100 ose më shumë pikë ashtu siç ka bërë deri tani. Nëse vazhdojnë kështu ne nuk do t'i kapim. Duhet të jemi pothuajse perfekt, do të thosha, që nga këtu deri në fund të sezonit dhe shpresoj se ata do të bien pak në paraqitjen e tyre, sepse ndaj Newcastle ishin të shkëlqyer", ka thënë Guardiola.

Bayerni arrin marrëveshje me Blindin

Bayern Munchen ka arritur një marrëveshje me Daley Blind, i cili i dha fund aventurës me Ajaksin në ditën e parë të vitit 2023. Mbrojtësi i majtë do të firmosë deri në fund të sezonit me kampionët e Gjermanisë, sipas raportimeve të shtypit holandez, me parametra zero. 32-vjeçari luan edhe në qendër të mbrojtjes dhe mund të përdoret si një "xhol" nga strategu Nagelsmanni, i cili ka humbur shërbimet e Lucas Hernandez (i lënduar). Blindi ka fituar tituj me Ajaksin dhe Manchester Unitedin, teksa ka veshur 99 herë fanellën e kombëtares holandeze. Blind do t'u bashkohet lojtarëve të tjerë holandezë si Matthijs De Ligt, Noussair Mazraoui dhe Ryan Gravenberch në Bayern.

Inzaghi: Treguam besim të madh në fushë

Trajneri Simone Inzaghi ishte i kënaqur me paraqitjen e Interit kundër liderëve të Serisë A, Napolit. Pas përfundimit të sfidës, ai ka folur për mikrofonat e "DAZN". "Ne jemi në një seri të mirë, pasi fituam kundër Napolit që ishte i pamposhtur dhe kështu është një injeksion i madh besimi. Jam krenar për djemtë e mi sepse ata ndihmuan njëri-tjetrin në fushë. Ishte një kënaqësi për t'i parë ata duke luajtur. Një ndeshje e mrekullueshme edhe për publikun dhe për klubin. Kishte kuriozitet për t'u rikthyer pas kaq shumë ditësh pushimi, por isha i qetë sepse ishim stërvitur në mënyrë të mirë që nga ajo kohë", ka thënë Inzaghi. "Dzeko po bën shumë mirë, ka teknikë dhe forcë, po na ndihmon shumë në këtë ecuri që nis nga larg. 96 minuta përqendrim i lartë nga ana jonë, mund të kishim shënuar edhe më herët, por kishte pak paqartësi përveç aftësive të Meret. Skuadra e ka mbajtur gjithmonë përqendrimin lart, fitorja ndaj Napolit duhet të na japë besim të madh për të ardhmen", ka shtuar Inzaghi.

PSG-ja e dëshiron Dembele, Barça kërkon 100 milionë euro

PSG-ja ka shfaqur interesim në orët e fundit për sulmuesin e krahut të Barcelonës, Osman Dembele. Al Kelaiqi kërkon t'i shtojë një tjetër pjesëtar të kombëtares franceze klubit parisien. Klubi francez është gati të paguajë deri në 50 milionë euro për lojtarin. Por në Barcelonë nuk kanë ndër mend të tërhiqen lehtë. Siç bën me dije e përditshmja katalanase, "Sport", klubi spanjoll ia ka bërë të qartë PSG-së se nëse dëshiron shërbimet e Dembelesë, duhet të derdhë plot 100 milionë euro në arkat e saj.

Presidenti i FIA-s hap dyert për skuadrat e reja në Formula 1

Presidenti i FIA-s, Mohammed Ben Sulayem, ka njoftuar se organi drejtues i Formulës 1 do ta fillojë procesin për të kërkuar skuadra të reja të mundshme për t'u bashkuar me rrjetin.

Aktualisht rrjeti përbëhet nga 10 konstruktorë, me Haasin që iu bashkua së fundmi. Ish-piloti i F1, Michael Andretti, nuk e ka fshehur ambicien e tij që Andretti Global të bëhet ekipi i 11-të i sportit,

megjithëse këto plane deri më tani nuk janë përgjigjur. Megjithatë, njoftimi i Ben Sulayem mund t'i hapë derën Andrettit, i cili tashmë drejton ekipe në IndyCar, Indy Lights, Indy Pro 2000 dhe Formula E,

dhe të tjerë për të fituar një vend në rrjet. "Kam kërkuar nga ekipi im FIA të shikoj njsjen e një procesi të shprehjes së interesit për skuadrat e reja të ardhshme për Kampionatin Botëror FIA

F1", ka shkruar Ben Sulayem në "Twitter". Megjithatë, duke folur për "Sky Sports" në shtator, presidenti dhe CEO i F1 Stefano Domenicali ishte i bindur se ekipi i 11-të nuk ishte një prioritet për sportin.



Oda e Stomatologëve të Kosovës
Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosova

Në mbështetje të nenit 21 paragrafi 1 nënparagrafi 1.11 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor Nr. 04/L-150, nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës të Republikës së Kosovës Rregullores për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në shërbimin profesional të OSK-së, Oda e Stomatologëve shpall këtë:

Konkurs për Zyrtar Financiar për kohë të pacaktuar

Detyrat kryesore:

- Kryerja e pagesave me rregull sipas sistemit të pagesave;
- Pranimi i palëve në zyrë të OSK-së për çështje financiare;
- Kontaktimi dhe pranimi i telefonatave nga palët për çështje financiare;
- Kompletimi i dokumentacioneve të ndryshme të natyrës financiare duke përfshirë: mbledhjen, sistemin, vendosjen dhe mirëmbajtjen e tyre në dosjet përkatëse;
- Ofron asistencë në kryerjen e punëve rreth çështjeve dhe detyrave të ndryshme administrative/financiare për nevojat e shërbimit financiar në kuadër të OSK-së;
- Asiston në procedurat gjatë realizimit dhe regjistrimit të transaksioneve të ndryshme financiare në patformën financiare të OSK-së, me mbikëqyrje nga ana e Zyrtarit të Lartë Financiar;
- Merrë pjesë në mbledhjet e Komisionit për Buxhet dhe Financa të OSK-së;
- Kryen edhe punë tjera nga fusha e përgjegjësisë dhe specifikimeve të përcaktuara nga Zyrtari i Lartë Financiar dhe Kryetari i OSK-së.

Aftësitë/ përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen :

- Të ketë kryer Fakultetin Ekonomik apo drejtime të përafërta;
- 1 (një) vit përvojë punë në financa;
- Njohja e gjuhës angleze do të konsiderohet përparësi;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access).
- Përparësi është njohja e gjuhës angleze.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore, aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Procedurat e konkurimit:

Procedura e konkurimit është e hapur për kandidatët e jashtëm.

Paraqitja e kërkesave:

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve: Zyra administrative e OSK-së, Ulpianë Rr. Mark Dizdari, D7 Hyrja II nr.6.
Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në numër telefoni 045-240-588, prej orës 9:00 – 15:00 ose email adresën odastomatologjike@gmail.com

Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbdhjetë) ditë kalendrike, nga dita e publikimit, përkatësisht deri më datën 21.01.2022. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit për kualifikimin dhe dokumente tjera të nevojshme që kërkohen vendi i punës. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Nexhmedin Sylaj shpall të pavlefshme certifikatën e Aftësisimit Profesional Organizim në Punë-Njohje me Pajisje dhe Vegla, Vizatim Teknik Lexim i Planit Beton.

- Agron Hapqiu shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Damir Shabani shpall te pavlefshme 4 dëftesa dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Behar Berisha shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Fiton Baxhaku shpall te pavlefshme 4 dëftesa dhe regjistrimi i vitit X instalues elektrik shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Orhan Opoja shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Florije Zatriqi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomë e sh.m. ekonomike "Kadri Kusari".

- Egon Morina nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Ardolina Binaku nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X,XIMXII dhe diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi"

- Besim Gjuga shpall të pavlefshme dëftesën e sh.f.m.u. "Shaban Gola" Lipovec KK Gjakovë, nga kl. VI-IX.

- Nue Kita nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. I,II,III,IV të sh.m.ekonomike "Kadri Kusari.

- Ardian Lekaj nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjmnazit "Hajdar Dushi".

- Avni Hajdari shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfm " Dy Dëshmorët " Pirane.

- Fesal Hyseni shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren.

- Altina Badalli shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Ali Ahmetaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Vjollce Fandaj shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmgj " Jeta e Re " Suhareke.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.

- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

www.facebook.com/gjejpuneshpejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs



Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate

Departamenti i Burimeve Njerëzore të PK-së/ Uprava za Ljudske Izvore PK-a/ Department for Human Resources

Në bazë të Ligjit për Policinë, kreu V, neni 44, Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, kreu II, neni 8, Ligji për Barazi Gjinore nr. 05/L-020, neni 5 dhe 6, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi nr. 05/L-021, neni 7, Udhëzimin Administrativ 01/2021 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, kapitulli III neni 8, neni 9 pika 1 dhe 2, dhe Vendimin e Drejtorit të Përgjithshëm datë: 04/01/2023 me nr ref: DBN 07/01/2023, Policia e Kosovës për të gjitha minoritetet shpall:

KONKURS

Për pranimin e zyrtarëve policorë sipas kushteve të parapara të konkurrimit për të gjitha minoritetet (Serb, Boshnjak, Turq, Goran, Romë, Ashkali, Egjiptas, Kroat, Malazez, Maqedonas).

Vendi i punës: Drejtoria Rajonale e Policisë Mitrovicë Veri.

A. Kandidatët që aplikojnë për zyrtarë policorë në Policinë e Kosovës duhet t'i përmbushin këto kritere:

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të jetë i moshës 18-30 vjeçar;
- Të ketë të përfunduar shkollimin e mesëm;
- Të jetë në gjendje të mirë fizike, mentale dhe emocionale;
- Të mos jetë i dënuar për ndonjë vepër penale;
- Të mos posedojë në vend të dukshëm tatuazh (fyturë, qafë, duar);
- Të ketë integritet personal dhe vlera të larta etike.

B. Testet:

- Testi me shkrim;
- Testi i aftësive fizike;
- Intervista;
- Testi psikologjik;
- Kontrollimi mjekësor;
- Verifikimi i të kaluarës.

C. Forma e aplikimit:

Aplikimi të bëhet në formën fizike që nënkupton se aplikacioni duhet të shkarkohet nga faqja zyrtare e Policisë së Kosovës në adresën www.kosovopolice.com / **Shpallje/Mundësi punësimi** Aplikacioni i plotësuar së bashku me dokumentet tjera mund dërgohet fizikisht në stacionin më të afërt të Policisë ose të dërgohet përmes postës elektronike (email) në adresën: rekrutimi@KosovoPolice.com.

D. Në aplikim duhet bashkangjitur dokumentet e kërkuara si:

- Kopja e diplomës për arsimin e mesëm të lartë, ndërsa për kandidatët që kanë përfunduar shkollimin jashtë vendit kopja e diplomës e nostifikuar;
- Dëshmi për kualifikime tjera;
- Certifikatën e lindjes/ekstrakt i lindjes;
- Vërtetimi nga gjykata që nuk është i dënuar dhe që nuk është nën hetim;
- Kopje e letërnjoftimit apo pasaportës
- Një fotografi të formatit (5 x 5);
- Dokument nga pika **c** dhe **d** të jenë të vlefshme dhe të nxirën pas datës së shpalljes së konkursit.

E. Detyrat dhe autorizimet e përgjithshme të Policisë

- Të mbrojnë jetën, pronën dhe të ofrojnë siguri për të gjithë personat;
- Të mbrojnë të drejtat dhe liritë themelore të gjithë personave;
- Të parandalojnë rrezikun ndaj qytetarëve dhe ta mbajë rendin dhe sigurinë publike;
- Të parandalojnë dhe t'i zbulojnë veprat penale dhe kryesit e tyre;
- Të hetojnë veprat penale dhe kryesit e tyre;
- Të mbikëqyrnë dhe të kontrollojnë sigurinë në komunikacion;
- Të menaxhojnë dhe të kontrollojnë kufirin shtetëror;
- Të ofrojnë ndihmë gjatë fatkeqësive natyrore dhe në raste të tjera emergjente; dhe
- Të kryejnë detyra të tjera të parapara me Ligjin e Policisë.

Kandidatet e interesuar mund të aplikojnë nga data **05/01/2023 deri me datën 26/01/2023**.

Për informata më të hollëshme mund të kontaktoni në numrat e telefonit: 038-5080 lokali: 1554 apo 1722 si dhe në 038/245-184, prej orës 09:00-15:00.

Pas përzgjedhjes së aplikacioneve kandidatët e suksesshëm do të ftohen të marrin pjesë në testimet e cekura më lart.

Informimi i kandidatëve lidhur me çdo fazë të testimet do të publikohet në ueb faqen zyrtare të Policisë së Kosovës, në adresën: www.kosovopolice.com dhe në tabelat e shpalljeve nëpër Drejtoritë Rajonale dhe Stacionet Policore përkatëse.

“Policia e Kosovës i shërben gjithë popullit të Kosovës. Ky shërbim ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga këto minoritete”.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme
Ministarstvo Unutrašnjih Poslova
Ministry of Internal Affairs



Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate

Departamenti i Burimeve Njerëzore të PK-së/ Uprava za Ljudske Izvore PK-a/ Department for Human Resources

Na osnovu Zakona o Policiji, poglavlje V, član 44, Zakona o Radu Br. 03/L-212, poglavlje II, član 8, Zakon o ravnopravnosti polova br. 05/L-020, član 5 i 6, Zakona o zaštiti od diskriminacije br. 05/L-021, član 7, Administrativnog Uputstva 01/2021 o radnom odnosu u Policiji Kosova, poglavlje III član 8, član 9 tačka 1 i 2, i Odluku Generalnog Direktora datuma: 04/01/2023 pod ref br: DLJI 07/01/2023, Policijska Kosova za sve manjine objavi:

KONKURS

Za prijem policijskih službenika po pretpostavkama konkursa za sve manjine (Serbi, Bošnjaci, Turci, Gorani Romi, Aškali, Egipcani, Hrvati, Crnogorci, Makedonci),

Radno mesto: Regionalna Direkcija Policijska Kosova Mitrovica Sever

A. Kandidati koji se prijavljuju za policijske službenike u Policiji Kosova moraju ispuniti sledeće kriterijume:

- Da bude Državljanin Republike Kosova ;
- Imati 18-30 godina ;
- Da ima završeno srednje obrazovanje ;
- Da je u dobrom fizičkom, psihičkom, i emocionalnom stanju;
- Da nije osudjivan za krivično delo ;
- Da nema tetovažu na vidljivom mestu (lice, vrat, ruke) ;
- Da ima lični integritet i visoke etičke vrednosti .

B. Testovi :

- Pismeni test ;
- Test fizičkih sposobnosti ;
- Intervju ;
- Psihološki test ;
- Lekarski pregled ;
- Provera prošlosti .

C. Formular prijave :

Prijave na konkurs za policijske službenike , biće na fizičkom obliku ,što podrazumeva da se aplikacija treba da se preuzima sa službene stranice PK : www.kosovopolice.com / **Oglas/Mogućnosti zapošljavanja, za popunjavanje**. Popunjena aplikacija zajedno sa ostalom dokumentacijom može da se dostavi u fizičkom obliku u najbližoj stanici policije ili da se dostave skenirano preko email adrese: rekrutimi@Kosovopolice.com

D. Na aplikaciji , moraju biti priloženi zahtevani dokumenti uz prijavu kao što su :

- Kopija diplome o visokom , srednjem obrazovanju , dok za kandidate koji su obrazovanje završili u inostranstvo, overenu kopiju diplome ;
- Dokaz o drugim kvalifikacijama ;
- Izvod iz matične knjige rođenih /izvod rođenih ;
- Uverenje od suda da nije osudjivan i da nije pod istragom ;
- Kopija lične karte , ili pasoša
- Fotografija formata (5 x 5);
- Dokument iz tačaka **c** i **d** moraju biti validni i zacrtnjeni nakon datuma objavljivanja konkursa .

E. Dužnosti i opšte dužnosti Policijske

- Da zaštiti život, imovinu i obezbediti sigurnost svih lica ;
- Da štiti osnovna prava i slobode svih lica ;
- Sprečavanje opasnost po građane i održavanje reda i javne bezbednosti;
- Sprečavanje i otkrivanje krivičnih dela i njihovih izvršilaca ;
- Da istražuje krivična dela i njihove izvršioce ;
- Nadgleda i kontroliše bezbednost saobraćaja ;
- Upravlja i kontrolisati državnu granicu ;
- Pružanje pomoći tokom prirodnih katastrofa i drugih vanrednih slučajeva; i
- Obavlja druge poslove predviđene sa Zakonom o Policiji .

Zainteresovani kandidati mogu da apliciraju od datuma **05/01/2023 do datuma 26/01/2023**.

Za detaljne informacije možete se obratiti na brojeve telefona t: 038-5080 lokalini : 1554 ili 1722 kao i na 038/245-184, od 09:00 do 15:00 časova .

Nakon selekcije prijava , uspešni kandidati će biti pozvani da učestvuju na gore navedenim testovima. Informisanje kandidata u vezi sa svakom etapom testova biće objavljene na zvaničnom sajtu Policijske Kosova , i na adresi: www.kosovopolice.com kao i na oglasnim tablama u relevantnim Regionalnim Direkcijama i Policijskim Stanicama .

“Policijska Kosova služi svim građanima Kosova. Ova služba nudi jednake mogućnosti zapošljavanja za sve građane Republike Kosova , i pozdravlja prijave svih muških i ženskih lica iz ovih manjina ”.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS


Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



PASHTETË PULË



gluten
free



100% mish pulë

cilësi e garantuar

pa konservues

MEKA
HALAL FOOD